




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Data / Datë / Date: 04 - 09 2018		viti / god / year: 8	
SKPMSEK	5061/2018	111	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 203 /2018

Datë: 16.08.2018

Në mbështetje të nenit 10 paragrafit 1 nënparagrafit 1.2, nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-192 Për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.10 dhe 1.14, nenit 10 të Rregullores Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 13 paragrafit 1 nënparagrafit 1.2 si dhe nenit 14 të Rregullores Nr. 01/2015 për Procedurat e Vëzhgimit për Emërimin e Nëpunësve Civilë të Nivelit Drejtues, pasi shqyrtoi raportin me rekomandimin e Kolegjit të Këshillit për vëzhgimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “Drejtori i Departamentit të Inovacionit” në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Këshilli në mbledhjen e gjashtëmbëdhjetë (XVI) të mbajtur më datë 16.08.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit për vëzhgimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “Drejtori i Departamentit të Inovacionit” në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, me të cilin **anulohet** procedura e rekrutimit sepse është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, për zbatimin këtij vendimi, brenda 15 ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi.
3. Raporti i Kolegjit të Këshillit për vëzhgimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “Drejtori i Departamentit të Inovacionit” në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, është pjesë e bashkangjitur e këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Eshref SHABANI

Kryetar i Këshillit

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe
- Arkivit të Këshillit.



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dërguar Received / Delivered	04 - 09	8	viti year
Qëllimi / Tema Topic / Subject	Nr. Prot. Pr. No.	Shënim Appendix	Shtesa Quantity
SKPM SHK	5061/2018		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT OOAD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

V.nr.177/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për vëzhgim i përbërë nga: Gjylinaze Gola-Kryesuese dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, bazuar në nenin 16 paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 03/L -192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 01/2015 për Rregullat dhe Procedurat e Vëzhgimit për Emërimin e Nëpunësve Civilë të Nivelit Drejtues si dhe Vendimin me numër V.nr.177/2018 të datës 18.05.2018 për pjesëmarrje në procedurën e vëzhgimit për pozitën “Drejtor i Departamentit të Inovacionit” të shpallur Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, me datë 16.08.2018, paraqet këtë:

R A P O R T

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 15.05.2018 nëpërmjet shkesës me numër protokollit 2695/2018 është njoftuar nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë për shpalljen e konkursit të jashtëm për pozitën “Drejtor i Departamentit të Inovacionit”. Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 18.05.2018 nxjerr Vendim me numër V.nr.177/2018 me të cilin bënë emërimin e Kolegjit lidhur me vëzhgimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “Drejtor i Departamentit të Inovacionit” në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

Kolegji për vëzhgim, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit ka konstatuar që Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë konkursin për pozitën “Drejtor i Departamentit të Inovacionit” e ka shpallur konkurs të jashtëm më datë 11.05.2018 duke u bazuar në shkresën e aprovimit për autorizim të shpalljes publike të lëshuar nga DASHC-Ministria e Administratës Publike e datës 10.05.2018 dhe duke u bazuar në dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil të Kosovës, ku në autorizimin e DASHC.MAP është dhënë arsyetimi se: ***“Plotësimi i vendit të lirë të punës bëhet sipas organogramit shpallja e pozitës me procedurë të jashtme me arsyen sepse nuk ka staf të mjaftueshëm të punësuar brenda institucionit pasi që është institucion i ri”***.

Kushtet kryesore të parashtruara në konkursin e rishpallur për pozitën “Drejtor i Departamentit të Inovacionit” të shpallur nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, kanë qenë:

• ***Diplomë Universitare në Inxhinieri, ekonomi, juridik, administratë publike; 7 vite përvojë pune profesionale, dhe së paku 4 vite përvojë pune në pozita drejtuese.***

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, më datë 11.06.2018 ka përcjell në Këshill materialin e procedurës deri në fazën e testimit me gojë duke njoftuar që testimi me gojë do të mbahet më datë 13.06.2018. Kolegji për vëzhgim, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, ka konstatuar se u.d. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, me datë 28.05.2018 ka nxjerr Vendimin me Nr. 26/2018 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil prej 5 anëtarëve, me këtë përbërje:



1. Mentor Sylmeta, u.d. Sekretar i Përgjithshëm-kryetar i Komisionit;
2. Fitim Sadiku-Sekretar i Përgjithshëm-anëtar;
3. Arton Berisha-Sekretar i Përgjithshëm-anëtar
4. Arben Çitaku-Sekretar i Përgjithshëm-anëtar dhe
5. Guner Ureya-Udhëheqës i Departamentit për Diplomaci Ekonomike-anëtar;

Kolegji për vëzhgim, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, ka konstatuar se Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë më datë 28.05.2018 ka përgatitur deklaratën për mos përfaqësim në aspektin gjinor në Komisionin Përzgjedhës i Shërbimit Civil në këtë rast ky komision është themeluar në pajtim me nenin 7 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për vëzhgim, gjatë shqyrtimi të dokumentacionit të ofruar ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka shqyrtuar aplikacionet e njëmbëdhjetë (11) kandidatëve si në vijim:

1. Laura Perjuci-Zherka,
2. Gylshen Caca,
3. Mustafë Shala,
4. Shenaj Tyrbedari-Hoxha,
5. Isuf Jashari,
6. Sadri Alija,
7. Dardan Ilazi,
8. Ruzhdi Osmani,
9. Valbona Fazliu-Rregcaj,
10. Visar Xani dhe
11. Gafurr Arifi.

Kolegji për vëzhgim, gjatë shqyrtimi të dokumentacionit të ofruar ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka shqyrtuar aplikacionet e kandidatëve dhe më datë 01.06.2018 ka përgatitur listën e shkurtër prej shtatë (7) kandidatëve (Laura Perjuci-Zherka, Mustafë Shala, Isuf Jashari, Ruzhdi Osami, Valbona Fazliu-Rregcaj, Visar Xani dhe Gafurr Arifi), ku Kolegji për vëzhgim, ka konstatuar që përveç kandidatës Valbona Fazliu-Rregcaj e cila nuk ka plotësuar kushtet e konkursit pasi që në vitin 2006 ka diplomuar në degën Gjuhë dhe Letërsi-Angleze ndërsa në vitin 2017 në Master i Shkencave Juridike Ndërkombëtare por e njëjta edhe pse është përfshirë në listën e shkurtër nuk ka marr pjesë në fazën e testit me shkrim dhe me gojë dhe në këtë rast konsiderohet që është tërheq nga procedura e rekrutimit sipas nenit 32 paragrafit 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil në këtë rast Kolegji për vëzhgim, ka vlerësuar se nuk është cenuar parimin i meritës, ndërsa kandidatët që nuk janë përfshirë në listën e shkurtër nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Kolegji për vëzhgim, gjatë shqyrtimi të dokumentacionit, ka konstatuar se testi me shkrim që është mbajtur më datë 07.06.2018 kanë qenë të gjithë kandidatët e listës së shkurtër. Testi me shkrim ka qenë i përpiluar prej tri (3) pjesëve, ku në pjesën e parë (pjesa e njohurive të përgjithshme) kandidatëve u ishin parashtruar tri (3) pyetje me përgjigje në formë eseje, në pjesën e dytë (pjesa e aftësive të përgjithshme dhe personalitetit) kandidatëve u ishin parashtruar dymbëdhjetë (12) pyetje me përgjigje të shumëfishta ndërsa në pjesën e tretë (pjesa e njohurive që lidhen me vendin e punës) kandidatëve u ishin parashtruar gjashtëmbëdhjetë (16) pyetje ku tetë (8) prej tyre ishin me përgjigje të shumëfishta ndërsa tetë (8) tjera me përgjigje në formë eseje në këtë kuptim testi me shkrim ka qenë i përpiluar në pajtim me nenin 36 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për vëzhgim, gjatë shqyrtimi të dokumentacionit, ka konstatuar se në testin me shkrim kanë marr pjesë katër kandidatë (Laura Perjuci-Zherka, Gafurr Arifi, Ruzhdi Osmani dhe Isuf Jashari), ndërsa testin me shkrim e

kanë kaluar tre (3) kandidatët pasi që kandidati Isuf Jashari nuk e ka kaluar. Kolegji për vëzhgim, më datë 13.06.2018 nga ora 10:30 ka marr pjesë në testin me gojë të kandidatët dhe në testin me gojë janë ftuar të tre (3) kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim dhe të cilët kanë marr pjesë në testin me gojë.

Kolegji për vëzhgim, ka konstatuar se gjatë procesit të testimit me gojë, anëtarët e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil kandidatëve iu kanë parashtruar pyetjet e njëjta dhe iu është dhënë kohë e duhur për përgjigje dhe e gjithë procedura e testimit është zhvilluar pa pengesa konform dispozitave të nenit 38 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Në bazë të njoftimit të datës 18.06.2018 të dërguar nga Ministria së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Kolegji për vëzhgim, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil për pozitën “Drejtor i Departamentit të Inovacionit” ka rekomanduar kandidaten Laura Perjuci- Zherka e cila në bazë të dëshmimeve posedon Diplomën me Nr. 137 të datës 15.01.2004 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës/Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës me të cilin dëshmohet se më datë 17.12.2003 ka mbaruar studimet duke marr titullin “Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës”, me përvojë pune si në vijim: prej datës 04.04.2004 deri më datë 30.04.2006 në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në pozitën “Shef i Sektorit për Bashkëpunim Ndër komunal”, prej vitit 2001 deri më 2008 në pozitën “Bashkëpunëtore e Veprimtarisë së Pavarur Projektuese” në ARCH STUDIO”, prej vitit 2008-2009 Këshilltare Politike e ZV. Ministrit të MMPH, nga viti 2009 deri në shtator 2017 pozitën “Shefe e Kabinetit” e Zëvendës Kryeministrit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ne mbledhjen e mbajtur, ka kërkuar nga Kolegji i Këshillit që të kërkojnë prova shtesë, dokumentacionin me qëllim të vendosjes në mënyrë meritore të kërkohej edhe këto prova nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Akt emërimet e të gjithë nëpunësve civil, Kualifikimin e tyre (Kopjet e Diplomave Universitare) si dhe Vërtetim mbi përvojën e punës për secilin nëpunës civil të cilët figurojnë në listën e pagave të muajit Prill dhe Maj të vitit 2018. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me qëllim që të vendoset në mënyrë sa më meritore për procedurën më datë 16.07.2018, ka kërkuar informata zyrtare që të njoftohet Këshilli sa është numri i të punësuarve në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ndërsa më datë 17.07.2018 jemi njoftuar që në bazë të listës së pagave në muajin prill kanë qenë të punësuar vetëm dy nëpunës civil, por më datë 18.07.2018, është kërkuar lista e pagave për muajin prill dhe maj 2018 të cilat janë përcjell dhe në bazë të shqyrtimit të tyre konstatohet se në muajin prill ka qenë i punësuar vetëm një nëpunës civil ndërsa në bazë të listës së pagave në muajin maj janë të punësuar tetë (8) nëpunës civil. Po ashtu, Këshilli ka kërkuar nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë të gjitha akt Emërimet, dëshmitë e kualifikimeve profesionale dhe dëshmitë për përvojë të punës së nëpunësve civil. Më datë 03.08.2018 janë dërguar të gjitha provat e kërkuar dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka konstatuar nëpunësit civil që janë në listë të pagave Akt Emërimet i kanë nënshkruar më datë 16.04.2018 me çka nënkupton se marrëdhënia e tyre e punës ka filluar nga data 16.04.2018, rrjedhimisht Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë me rastin e shpalljes së konkursit për pozitën “Drejtor i Departamentit të Inovacionit”, ka pasur më shumë se tre (3) të punësuar. Me datën 16.09.2018, Kryetarja e Kolegjit për vëzhgim, ka prezantuar Raportin për pozitën “Drejtor i Departamentit të Inovacionit” në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Me shumicën e votave të anëtareve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është anuluar kjo pozitë, dhe në këtë kuptim Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 4 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë ku përcaktohet që për pozitën e nivelit drejtues pranimi kryhet nëpërmjet procedurave të ngritjes në detyrë të nëpunësve civil, në rast se nuk ka konkurrenës apo kanë rezultuar të pa papërshtatshëm pranimi hapet për të gjithë të interesuarit, në këtë kuptim Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ka qenë e obliguar fillimisht të bëjë shpalljen e konkursit të brendshëm.

Andaj bazuar në nenin 16, paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 5 paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të Rregullores Nr. 01/2015 për Rregullat dhe procedurat e Vëzhgimit për Emërimin e Nëpunësve Civilë të Nivelit Drejtues dhe dokumentacionin e shqyrtuar gjatë procesit të vëzhgimit, Kolegjit për vëzhgim, paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

Kolegji për vëzhgim, ka konstatuar se Ministria së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në lidhje me procesin e rekrutimit për pozitën “Drejtor i Departamentit të Inovacionit”, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për vëzhgim, i **rekomandon** Këshillit që të anuloj përzgjedhjen përfundimtare e kandidatit për pozitën “Drejtor i Departamentit të Inovacionit” në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

I dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit;
- Dosjes së lëndës.

Gjylinaze Gola
Kryesuese e Kolegjit



Avdyl Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

